<p>KAPITULLI VII ORGANIZIMI DHE UDHËHEQJA E IKIH-së</p> <p style="text-align: center;">Neni 19</p> <p>Struktura organizative e IKIH-së përbëhet nga: Autoriteti, Këshilli dhe Grupet Punuese të IKIH-së.</p> <p style="text-align: center;">Neni 20 Autoriteti i IKIH-së</p> <p>Autoriteti i IKIH-së ka rol udhëheqës i cili përbëhet nga Kryetari dhe anëtarët.</p> <p style="text-align: center;">Neni 21 Udhëheqësia e autoritetit të IKIH-së</p> <p>1. Autoriteti i IKIH-së kryesohet nga Zëvendës Kryeministri i Qeverisë së Republikës së Kosovës.</p> <p>2. Kryetari i Autoritetit të IKIH-së kujdeset për zbatimin e vendimeve, për strategjinë e IKIH-së, shkëmbimin e të dhënave hapësinore me shtete tjera si dhe informon Qeverinë për aktivitetet e IKIH-së.</p>	<p>CHAPTER VII ORGANIZATION AND MANAGEMENT OF NSII</p> <p style="text-align: center;">Article 19</p> <p>NSII organizational structure consists of: NSII Authority, Council and Working Groups.</p> <p style="text-align: center;">Article 20 NSII's Authority</p> <p>NSII Authority has a leading role, which consists of Chairman and members.</p> <p style="text-align: center;">Article 21 NSII 's authority leadership</p> <p>1. NSII Authority is chaired by the Deputy Prime Minister of the Republic of Kosova.</p> <p>2. Chairman of the NSII's authority cares for implementing decisions to NSII's strategy, spatial data exchange with other countries and informs the Government on NSII activities.</p>	<p>POGLAVLJE VII ORGANIZACIJA I RUKOVOĐENJE NIPP-a</p> <p style="text-align: center;">Član 19</p> <p>Organizaciona struktura NIPP-a samtoji se od: autoriteta, Saveta i Radne grupe NIPP-a.</p> <p style="text-align: center;">Član 20 Autoritet NIPP-a</p> <p>Autoritet Nipp-a ima rukovodeću ulogu koji se samtoji od Predsednika i članova.</p> <p style="text-align: center;">Član 21 Rukovodstvo autoriteta NIPP-a</p> <p>1. Autoritet NIPP-a rukovodi se od strane zamenika premiera Vlade Republike Kosovo.</p> <p>2. Predsednik autoriteta NIPP-a brine se o sprovođenju odluka, strategiju NIPP-a, razmenu prostornih podataka sa drugim zemljama kao i obaveštava Vladu o aktivnostima NIPP-a.</p>
---	--	--

<p align="center">Neni 22 Caktimi i anëtarëve për Autoritetin e IKIH-së</p>	<p align="center">Article 22 Appointment of members of the NSII's Authority</p>	<p align="center">Član 22 Imenovanje članova autoriteta NIPP-a</p>
<p>1. Autoriteti i IKIH-së përbëhet prej përfaqësuesve të:</p> <p>1.1. Ministrisë së FSK;</p> <p>1.2. Ministrisë së Punëve të Brendshme;</p> <p>1.3. Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik;</p> <p>1.4. Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural;</p> <p>1.5. Ministrisë së MAPL;</p> <p>1.6. Ministrisë së Kulturës, Rinisë, Sporteve dhe Çështjeve jo Rezidente;</p> <p>1.7. Ministrisë së Infrastrukturës;</p> <p>1.8. Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor;</p> <p>1.9. Ministrisë së Administratës Publike;</p> <p>1.10. Agjencia e Statistikave të Kosovës;</p> <p>1.11. Agjencia Kadastrale e Kosovës;</p>	<p>1. NSII's Authority consists of representatives from:</p> <p>1.1. Ministry of KSF;</p> <p>1.2. Ministry of Internal Affairs;</p> <p>1.3. Ministry of Economic Development;</p> <p>1.4. Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development;</p> <p>1.5. Ministry of MLGA;</p> <p>1.6. Ministry of Culture, Youth, Sports and Non Resident Issues;</p> <p>1.7. Ministry of Infrastructure;</p> <p>1.8. Ministry of Environment and Spatial Planning;</p> <p>1.9. Ministry of Public Administration;</p> <p>1.10. Statistical Agency of Kosovo;</p> <p>1.11. Kosovo Cadastral Agency;</p>	<p>1. Autoritet NIPP-a sastoji se od predstavnika:</p> <p>1.1. Ministarstva KBS-a;</p> <p>1.2. Ministarstva Unutrašnjih poslova;</p> <p>1.3. Ministarstva za Ekonomski Razvoj;</p> <p>1.4. Ministarstva Poljoprivrede, šumarstva i ruralnog razvoja;</p> <p>1.5. Ministarstva Administracije Lokalne Vlasti;</p> <p>1.6. Ministarstva Kulture, Omladine, Sporet i Nerezidentnih Pitanja;</p> <p>1.7. Ministarstva za Infrastrukturu;</p> <p>1.8. Ministarstva životne Sredine i Planiranja;</p> <p>1.9. Ministarstva Javne Uprave;</p> <p>1.10. Agencije za Statistiku Kosova;</p> <p>1.11. Katastarske Agencije Kosova;</p>

<p>1.12. Qyteti i Prishtinës;</p> <p>1.13. Asociacioni i Komunave të Kosovës;</p> <p>1.14. Odës Ekonomike e Kosovës;</p> <p>1.15. Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale;</p> <p>1.16. Agjencia Kosovare e Privatizimit;</p> <p>1.17. Agjencia Kosovare e Pronës.</p> <p>2. Përfaqësuesit e emëruar nga paragrafi 1. i këtij neni janë anëtarë të Autoritetit të IKIH-së.</p> <p>3. Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor është koordinatore e Autoritetit të IKIH-së dhe udhëheqëse e Komitetit Ndërministror për IKIH-në.</p> <p style="text-align: center;">Neni 23 Kompetencat e Autoritetit të IKIH-së</p> <p>1. Autoriteti i IKIH-së është kompetent për:</p> <p>1.1. Miratimin e procedurave për punën e Autoritetit të IKIH-së;</p>	<p>1.12. Prishtina City;</p> <p>1.13. The Association of Kosovo Municipalities;</p> <p>1.14. Kosova Chamber of Commerce;</p> <p>1.15. Independent Commission for Mines and Minerals;</p> <p>1.16. Privatization Agency of Kosovo;</p> <p>1.17. Kosovo Property Agency.</p> <p>2. Representatives appointed by paragraph 1. of this article are members of the NSII's Authority.</p> <p>3. Ministry of Environment and Spatial Planning is coordinator of the NSII's Authority and head of the Inter-Ministerial Committee for NSII.</p> <p style="text-align: center;">Article 23 Powers of the NSII's Authority</p> <p>1. NSII 's authority is responsible for:</p> <p>1.1. Approval of procedures for the work of the NSII's authority;</p>	<p>1.12. Grada Prištne;</p> <p>1.13. Asocijacije Kosovskih Opština;</p> <p>1.14. Ekonomske Komore Kosova;</p> <p>1.15. Nezavisne Komisije za Rudnike i Minerale;</p> <p>1.16. Kosovska agencija za privatizaciju;</p> <p>1.17. Kosovske agencije za imovinu.</p> <p>2. Imenovani predstavnici prema stavu 1. ovog člana su članovi autoriteta NIPP-a.</p> <p>3. Ministarstvo životne Sredine i Prostornog Planiranja koordinatork je autoriteta NIPP-a i rukovodilac Međuministarskog Odbora za NIPP.</p> <p style="text-align: center;">Član 23 Nadležnosti autoriteta NIPP-a</p> <p>1. Autoritet NIPP-a nadležan je za:</p> <p>1.1. Usvajanje procedura za rad autoriteta NIPP-a;</p>
---	---	---

<p>1.2. Miratimin e procedurave për punën e Këshillit dhe Grupeve punuese për IKIH-në si dhe udhëheqësin e grupeve punuese;</p> <p>1.3. Koordinimin e aktiviteteve për temat e IKIH-së;</p> <p>1.4. Propozon për aprovim strategjinë e IKIH -së- në Qeverinë e Republikës së Kosovës;</p> <p>1.5. Miratimi i Planit dhe Programit vjetor për zbatimin e strategjisë për IKIH-në;</p> <p>1.6. Monitorimi i zhvillimit të politikave të IKIH-së;</p> <p>1.7. Përgatitja dhe analizimi i iniciativave përkitazi me informacionet hapësinore në nivel lokal dhe qendror;</p> <p>1.8. Nxjerrja e vendimeve për palë të treta;</p> <p>1.9. Publikimin e vendimeve, udhëzimeve administrative, raporteve vjetore, si dhe dokumentacionet tjera për IKIH-në.</p> <p>2. Autoriteti mund të vendos që ky Ligj të aplikohet edhe për informacione dhe tema tjera të të dhënave që nuk janë përfshirë në</p>	<p>1.2. Approval of procedures for the work of the Council and working groups for NSII - in and leadership of the working groups;</p> <p>1.3. Coordination of activities on NSII topics;</p> <p>1.4. Proposes for approval of the NSII 's strategy, the Government of the Republic of Kosovo;</p> <p>1.5. Approval of the Plan and the Annual Programme for implementation of the NSII's strategy;</p> <p>1.6. Monitoring of the development of NSII's policies;</p> <p>1.7. Preparation and analysis of initiatives regarding spatial information at local and national level;</p> <p>1.8. Issuing decisions to third parties;</p> <p>1.9. Publication of decisions, administrative instructions, annual reports and other documents for NSII.</p> <p>2. The Authority may decide that this law be applied to information and other data subjects not included in Annex 1.</p>	<p>1.2. Usvajanje procedura za rad Veća i radnih grupa za NIPP kao i rukovodstvo radnih grupa;</p> <p>1.3. Koordinaciju aktivnosti za teme NIPP-a;</p> <p>1.4. Predlaže za odobrenje strategije NIPP-a u Vladi Republike Kosovo;</p> <p>1.5. Usvajanje plana i godišnjeg programa za sprovođenje strategije za NIPP;</p> <p>1.6. Praćenje razvoja politika NIPP-a;</p> <p>1.7. Pripremu i analizu inicijativa u vezi sa prostornim podacima na lokalnom i centralnom nivou;</p> <p>1.8. Donošenju odluka za treću stranu;</p> <p>1.9. Objavljivanje odluka, administrativnih uputstava, godišnjih izveštaja, kao i druge dokumentacije za NIPP.</p> <p>2. Autoritet može da odluči gde da se Zakon primeni i za druge informacije i druge teme podataka koji nisu uključeni u Dodatku 1.</p>
--	---	--

<p>shtojcën 1.</p> <p>3. Vendimet e Autoritetit të IKIH-së janë obligative për Këshillin dhe Grupet Punuese të IKIH-së.</p> <p>4. Agjencia Kadastrale e Kosovës e përkrah autoritetin e IKIH-së në aspektin administrativ dhe teknik.</p> <p style="text-align: center;">Neni 24 Këshilli i IKIH-së</p>	<p>3. NSII's Authority decisions are binding on the NSII Council and the Working.</p> <p>4. Kosovo Cadastral Agency supports the NSII Authority in administrative and technical aspects.</p> <p style="text-align: center;">Article 24 NSII's Council</p>	<p>3. Odluke autoriteta NIPP-a su obavezne za Savet i Radne grupe NIPP-a.</p> <p>4. Katastarska agencija Kosova podržava Autoritet NIPP-a u administrativnom i tehničkom aspektu.</p> <p style="text-align: center;">Član 24 Savet NIPP-a</p>
<p>1. Këshilli për IKIH-në është organ i përhershëm.</p> <p>2. Këshilli për IKIH-në është përgjegjës për zbatimin e objektivave, politikave dhe strategjive të miratuara nga autoriteti i IKIH-së.</p> <p style="text-align: center;">Neni 25 Anëtarët e Këshillit për IKIH-në</p> <p>1. Anëtarët e Këshillit për IKIH-në janë:</p> <p style="padding-left: 20px;">1.1. Udhëheqësit e Grupeve Punuese;</p> <p style="padding-left: 20px;">1.2. Përfaqësues të Agjencisë Kadastrale të Kosovës; dhe</p> <p style="padding-left: 20px;">1.3. Përfaqësues nga Autoriteti i IKIH-së.</p>	<p>1. NSII's Council is a permanent body.</p> <p>2. NSII's Council is responsible for implementation of objectives, policies and strategies approved by the NSII's authority.</p> <p style="text-align: center;">Article 25 NSII's Council members</p> <p>1. NSII's Council members are:</p> <p style="padding-left: 20px;">1.1. Leaders of the Working Groups;</p> <p style="padding-left: 20px;">1.2. Representatives of the Kosovo Cadastral Agency; and</p> <p style="padding-left: 20px;">1.3. NSII's authority representatives.</p>	<p>1. Savet NIPP-a je stalni organ.</p> <p>2. Savet NIPP-a je odgovoran za sprovođenje ciljeva, politika i strategija usvojenih od strane autoriteta NIPP-a.</p> <p style="text-align: center;">Član 25 Članovi Veća za NIPP</p> <p>1. Članovi Veća NIPP-a su:</p> <p style="padding-left: 20px;">1.1. Rukovodioci radnih grupa;</p> <p style="padding-left: 20px;">1.2. Predstavnik Katastarske agencije Kosova; i</p> <p style="padding-left: 20px;">1.3. Predstavnik od autoriteta NIPP-a.</p>

<p>2. Këshilli për IKIH-në cakton koordinatorin në kohëzgjatje prej tre vitesh nga Udhëheqësit e Grupeve Punuese të Këshillit.</p> <p>3. Këshilli i IKIH-së ka mbështetje administrative nga Agjencia Kadastrale e Kosovës.</p> <p style="text-align: center;">Neni 26 Përgjegjësitë e Këshillit për IKIH-në</p> <p>1. Këshilli për IKIH-në është përgjegjës për:</p> <p>1.1. Përgatitjen e Planit dhe Programit vjetor për zbatimin e strategjisë për IKIH-në;</p> <p>1.2. Koordinimin e zbatimit të Planit dhe Programit vjetor në konsultim me subjektet përbërëse të IKIH-së;</p> <p>1.3. Monitorimin e zbatimit të aktiviteteve të IKIH-së dhe informon Autoritetin për IKIH-në;</p> <p>1.4. Përgatitjen e raporteve vjetore për zbatimin e Planit dhe Programit vjetor të punës dhe të njëjtin e dorëzon për aprovim te Autoriteti i IKIH-së;</p>	<p>2. NSII's Council appoints coordinator in period of three years from among the leaders of the Council Working Groups.</p> <p>3. NSII Council has administrative support by Kosovo Cadastral Agency.</p> <p style="text-align: center;">Article 26 NSII's Council Responsibilities</p> <p>1. NSII's Council is responsible for:</p> <p>1.1. preparation of the annual plan and program for implementation of the NSII strategy;</p> <p>1.2. Coordinating the implementation of the annual plan and program in consultation with the constituent NSII's entities;</p> <p>1.3. Monitoring the implementation of the NSII's activities and informs the NSII's Authority;</p> <p>1.4. Preparation of annual reports on the implementation of the Annual Plan and Work Programme and the same shall be submitted for approval to the NSII's</p>	<p>2. Veće za NIPP imenuje koordinatora u trajanju od tri godine od strane rukovodioca radnih grupa veća.</p> <p>3. Veće za NIPP ima administrativnu podršku od Kosovske Katastarske Agencije.</p> <p style="text-align: center;">Član 26 Odgovornosti Veća NIPP-a</p> <p>1. Veće za NIPP odgovorno je za:</p> <p>1.1. Pripremu plana i godišnjeg programa za sprovođenje strategije NIPP-a;</p> <p>1.2. Koordinaciju sprovođenja plana i godišnjeg programa u konsultaciji sa sastavnim subjektima NIPP-a;</p> <p>1.3. Praćenje sprovođenja aktivnosti NIPP-a i obaveštava autoritet NIPP-a;</p> <p>1.4. Pripremu godišnjih izveštaja za sprovođenje plana i godišnjeg programa i isti dostavlja za usvajanje autoriteta NIPP-a;</p>
---	--	---

<p>1.5. Ofrimin e propozimeve për akte nënligjore të Autoriteti i IKIH-së, të përgatitura nga Grupet punuese;</p> <p>1.6. Ofrimin e këshillave të Autoriteti i IKIH-së lidhur me kërkesat nga palët e treta për qasje në rrjetin e IKIH-së.</p> <p style="text-align: center;">Neni 27 Grupet Punuese</p> <p>Me qëllim të ofrimit të ekspertizës teknike, këshillave dhe sugjerimeve të nevojshme për vendimmarrje dhe zbatimin e Planit dhe Programit vjetor të IKIH-së duhet formuar Grupet Punuese.</p> <p style="text-align: center;">Neni 28 Përgjegjësitë e Grupeve Punuese</p> <p>1. Grupet punuese hartojnë akte nënligjore nga fushat e tyre dhe të njëjtat ia paraqesin Këshillit të IKIH-së.</p> <p>2. Grupet punuese veprojnë sipas dispozitave të nenit 25 nënparagrafi 1.2.</p> <p>2. Për zbatimin e Planit dhe programit të IKIH-së formohen Grupet punuese si vijon:</p>	<p>Authority;</p> <p>1.5. Providing NSII's Authority with proposals for sub-legal acts prepared by Working Groups;</p> <p>1.6. Providing advice to the NSII Authority on requests from third parties for access to NSII network.</p> <p style="text-align: center;">Article 27 Working Groups</p> <p>Working groups shall be established in order to provide technical expertise, advices and suggestions needed for decision-making and the implementation of the annual NSII's Plan and Program.</p> <p style="text-align: center;">Article 28 Responsibilities of Working Groups</p> <p>1. Working groups draft sub-legal acts from their fields and the same shall submit to the NSII's Council.</p> <p>2. Working groups operate under the provisions of article 25 subparagraph 1.2.</p> <p>3. Working groups shall be established for the implementation of the NSII plan and program, as follows:</p>	<p>1.5. Pružanje predloga za podzakonske akte autoriteta NIPP-a, pripremljenog od radnih grupa;</p> <p>1.6. Pružanje gaveta autoritetu NIPP-a u vezi sa zahtevima od strane treće strane za pristup u mrežu NIPP-a.</p> <p style="text-align: center;">Član 27 Radne grupe</p> <p>U cilju pružanja tehničke stručnosti, saveta i predloga potrebnih za donošenje odluka i realizaciju plana i godišnjeg programa NIPP-a trebaju se osnivati radne grupe.</p> <p style="text-align: center;">Član 28 Odgovornosti radnih grupa</p> <p>1. Radne grupe izrađuju podzakonske akte iz njihovih oblasti i iste predstavljaju Veću NIPP-a.</p> <p>2. Radne grupe deluju u skladu sa odredbama člana 25 podstav 1.2.</p> <p>3. Za sprovođenje plana i programa NIPP-a osnivaju se sledeće radne grupe:</p>
--	---	--

<p>3.1. Grupi Punues për ndërtimin e kapaciteteve institucionale dhe ligjore;</p> <p>3.2. Grupi Punues për çështje teknike, standarde, metadata, shërbime etj;</p> <p>3.3. Grupi Punues për marrëdhënie me publikun dhe komunikim; si dhe</p> <p>3.4. Grupi punues për çështje ekonomike.</p> <p style="text-align: center;">Neni 29 Përbërja e Grupeve Punuese</p> <p>1. Grupet punuese sipas nenit 27 dhe 28 të këtij ligji përbëhen prej 5 - 10 anëtarë.</p> <p>2. Anëtarët e Autoritetit të IKIH-së i caktojnë nga institucionet e tyre përfaqësuesit e grupeve punuese.</p> <p>3. Për nevojat e grupeve punuese, Autoriteti i IKIH-së angazhon ekspertë të jashtëm.</p> <p>KAPITULLI VIII DISPOZITAT NDËSHKIMORE</p>	<p>3.1. Working Group to build legal and institutional capacity;</p> <p>3.2. Working Group on technical issues, standards, metadata, services etc.;</p> <p>3.3. Working Group for public relations and communication; as well as</p> <p>3.4. The working group on economic issues.</p> <p style="text-align: center;">Article 29 Composition of Working Groups</p> <p>1. Working groups under article 27 and 28 of this Law consist of 5-10 members.</p> <p>2. Members of the NSII's Authority appoint representatives of the working groups from among their institutions.</p> <p>3. For the needs of the working groups, the NSII's engages external experts.</p> <p>CHAPTER VIII PENALTY PROVISIONS</p>	<p>3.1. Radna grupa za izgradnju institucijalnih i pravnih kapaciteta;</p> <p>3.2. Radna grupa za tehnička pitanja, standarde, metapodatke, usluge itd.;</p> <p>3.3. Radna grupa za odnose sa javnošću i komunikacije; kao i</p> <p>3.4. Radna grupa za ekonomska pitanja.</p> <p style="text-align: center;">Član 29 Sastav radnih grupa</p> <p>1. Radne grupe prema članu 27 i 28 ovog Zakona sastoje se od 5 - 10 članova.</p> <p>2. Članovi autoriteta NIPP-a imenjuju se od strane njihovih predstavnika radnih grupa.</p> <p>3. Za potrebe radnih grupa, autoritet NIPP-a angažuje spoljne eksperte.</p> <p>POGLAVLJE VIII KAZNENE ODREDBE</p>
---	--	--

<p style="text-align: center;">Neni 30</p> <p>Me dënim me gjobë në të holla në shumë prej 1000 deri në 5000€ do të ndëshkohet për kundërvajtje personi përgjegjës i IKIH-së, nga neni 4. i këtij Ligji nëse nuk i siguron përgjegjësitë nga neni 5. paragrafi 1. nënparagrafi 1.1, 1.2. dhe 1.3. i këtij Ligji.</p>	<p style="text-align: center;">Article 30</p> <p>With a fine in the amount of money "1000-5000 €" will be applied for offences against the NSII responsible person, from article 4. of this Law unless it provides responsibilities in article 5. paragraph 1. subparagraph 1.1, 1.2. and 1.3. of this Law.</p>	<p style="text-align: center;">Član 30</p> <p>Novčanom kaznom u iznosu od 1000 do 5000€ kaznit će se za prekršaj odgovorno lice NIPP-a, iz člana 4, ovog Zakona ako ne osigura odgovornosti iz člana 5. stav 1. podstav 1.1, 1.2. i 1.3. ovog Zakona.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 31</p> <p>Pjesë përbërse e këtij ligji janë shtojcat 1, 2 dhe 3.</p>	<p style="text-align: center;">Article 31</p> <p>Integral part of this Law are annexes 1, 2 and 3.</p>	<p style="text-align: center;">Član 31</p> <p>Sastavni deo ovog zakona su Dodatci 1, 2 i 3.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 32 Hyrja në fuqi</p> <p>Ky Ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.</p>	<p style="text-align: center;">Article 32 Entry into force</p> <p>This law enters into force fifteen (15) days after publication in the Official Gazette of the Republic of Kosovo.</p>	<p style="text-align: center;">Član 32 Stupanje na snagu</p> <p>Ovaj Zakon stupa na snagu petnaest (15) dana nakon objavljivanja u Službenom Glasniku Republike Kosova.</p>
<p style="text-align: right;">Jakup Krasniqi</p> <hr style="width: 20%; margin-left: auto; margin-right: 0;"/> <p style="text-align: center;">Kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës</p>	<p style="text-align: right;">Jakup Krasniqi</p> <hr style="width: 20%; margin-left: auto; margin-right: 0;"/> <p style="text-align: center;">The President of the Assembly of Republic of Kosovo</p>	<p style="text-align: right;">Jakup Krasniqi</p> <hr style="width: 20%; margin-left: auto; margin-right: 0;"/> <p style="text-align: center;">Predsednik Skupštine Republike Kosova</p>

Temat e Informacioneve Hapësinore	Spatial Information Topics	Teme prostornih podataka
<p>Shtojca 1.</p> <p>1. Sistemi referent i koordinatave; Sistemet për referimin unik të informacioneve hapësinore në hapësirë si një tërsi e koordinatave (x,y,z) dhe/apo gjerësisë dhe gjatësisë gjeografike si dhe lartësisë, bazuar në datumin gjeodezik vertikal dhe horizontal.</p> <p>2. Sistemet e rrjetit gjeografik; Rrjeti shumë rezolucionesh i harmonizuar me pikë të përbashkët të origjinës, lokacion dhe madhësi të standardizuar të katrorit të rrjetit.</p> <p>3. Emrat gjeografik; Emrat e viseve, regjioneve, lokaliteteve, qyteteve, periferive të qyteteve, vendbanimeve, ndonjë veçori gjeografike ose topografike me interes publik ose historik.</p> <p>4. Njësitë administrative; Njësitë administrative, regjionet e veçanta ku Shtetet anëtare i ushtrojnë të drejtat nga juridiksioni për qeverisje lokale dhe qendrore, të cilat janë të ndara me kufijtë administrativ.</p> <p>5. Adresat; Lokacioni i pronave i bazuar në identifikimin</p>	<p>Appendix 1.</p> <p>1. Coordinate reference system; Unique referral systems for spatial information in space as an entirety of coordinates (x , y , z) and / or geographic breadth and length and height, based on vertical and horizontal geodetic datum.</p> <p>2. Geographical grid systems; Multi resolutions network harmonized to common point of origin, standardized location and size of the square grid.</p> <p>3. Geographical names; Names of areas, regions, localities, cities, suburbs of cities, settlements, or any geographical or topographical feature of public or historical interest.</p> <p>4. Administrative units; Administrative units Counties, particular areas where Member States exercise their jurisdiction to local and central government, which are separated by administrative boundaries.</p> <p>5. Addresses; Location of properties based on</p>	<p>Dodatak 1.</p> <p>1. Koordinantni referentni sistemi; Jedinstveni referentni sistemi prostornih podataka u prostoru kao celina koordinata (x,y,z) i/ili geografske širine i dužine kao i visine, na osnovu horizontalnog i vertikalnog geodezijskog datuma.</p> <p>2. Sistemi geografskih mreža; Harmonizovana više rezoluciona mreža sa zajedničkom tačkom porekla, standardizovane lokacije i veličine kvadrata mreže.</p> <p>3. Geografska imena; Imena područja, regiona, lokaliteta, gradova, gradskih predgrađa, naselja, nekih geografskih ili topografskih karakteristika od javnog ili istorijskog značaja.</p> <p>4. Upravne jedinice; Upravne jedinice, posebni regioni gde države članice izvršavaju svoju nadležnost za lokalno i centralno upravljanje, koje su razdvojene administrativnim granicama.</p> <p>5. Adrese; Lokacija imovine zasnovane na identifikaciji na</p>

<p>sipas adresës, zakonisht me anë të emrit të rrugës, numrit të shtëpisë, kodin e postës.</p> <p>6. Parcelat kadastrale; Sipërfaqet e definuara me anë të regjistrave kadastral apo të ngjashme.</p> <p>7. Rrjetat e transportit; Rrjetat e transportit rrugor, hekurudhor, ajror dhe infrastruktura përkatëse. Këtu përfshihen lidhjet në mes të rrjetave të ndryshme, gjithashtu edhe rrjeti trans evropian i definuar në Vendimin nr.1692/96/EC të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit Evropian të datës 23 korrik 1996, mbi Udhëzimet e Bashkimit Evropian për zhvillimin e rrjetit trans evropian⁴ të transportit dhe rishikimet e ardhshme të këtij vendimi.</p> <p>8. Hidrografia; Elementet hidrografike, përfshirë sipërfaqet me ujëra dhe të gjitha viset dhe objektet e lidhura me to, përfshirë shtretërit dhe nën shtretërit e lumenjve. Sipas përkufizimeve të percaktura me Udhëzimin 2000/60/EC të Parlamentit Evropian dhe Këshillit Evropian të datës 23</p>	<p>identification by address, usually by road name, house number, postal code.</p> <p>6. Cadastral parcels; Areas defined by cadastral registers or similar.</p> <p>7. Transport networks; Networks of road, rail, air and related infrastructure. Here are included connections between different networks, Trans European network also defined in Decision no.1692/96/EC of the European Parliament and the European Council of 23 July 1996, on the European Union guidelines for the development of the Trans European Network of transportation and future revisions of this decision.</p> <p>8. Hydrography; Hydrographic elements, including water surfaces and all parts and related facilities, including river beds and under beds. According to the definitions set out in Directive 2000/60/EC of the European Parliament and the Council dated 23</p>	<p>osnovu adrese, obično po imenu ulica, kućnog broja, poštanskog broja.</p> <p>6. Katastarske parcele; Površine definisane katastarskim popisima ili sličnim.</p> <p>7. Transportne mreže; Drumske transportne, železničke, vazdušne mreže i odgovarajuće infrastrukture. Ovde se obuhvataju veze između različitih mreža, takođe i trans- evropska mreža definisane u Odluci br.1692/96/EC Evropskog parlamenta i Evropskog saveta od 23 jula 1996 godine, o Uputstvima Evropske unije o razvoju trans-evropske mreže⁵ transporta i buduće revizije ove odluke.</p> <p>8. Hidrografija; Hidrografski elementi, uključujući i vodene površine i svih delova i pratećih objekata, uključujući rečna i podrečna korita. Prema definicijama utvrđenih Uputstvom 2000/60/EC Evropskog parlamenta i Evropskog saveta od 23 oktobra 2000 o stvaraju okvira aktivnosti</p>
--	--	---

⁴ OJ L 228, 9.9.1996, f. 1. Vendimi i ndryshuar së fundit me Vendimin nr. 884/2004/EC (OJ L 167, 30.4.2004, f. 1. Shtojca e korigjimit e publikuar në OJ L 201, 7.6.2004, f. 1).

⁵ OJ L 228, 9.9.1996, f. 1. Konačna izmenjena odluka sa Odlukom br. 884/2004/EC (OJ L 167, 30.4.2004, f. 1. Dodatak ispravke objavljene u OJ L 201, 7.6.2004, f. 1).

<p>tetor 2000 mbi krijimin e kornizës për aktivitetet e Bashkimit Evropian në fushën e rregullave për ujërat dhe në formën e rrjetave.</p> <p>9. Sipërfaqet e mbrojtura; Sipërfaqet e caktuara dhe administruara brenda kornizës ligjore ndërkombëtare, të Shteteve anëtare të Bashkimit Evropian dhe të Bashkimit Evropian për t'i arritur objektivat specifike të ruajtjes së këtyre sipërfaqeve.</p> <p>Shtojca 2.</p> <p>1. Lartësia; Modelet digjitale të lartësisë për tokë, akullnaja dhe sipërfaqe ujore. Përfshinë lartësinë tokësore, matjen e thellësisë dhe brigjeve të ujërave.</p> <p>2. Mbulesa e tokës; Mbulesa fizike dhe biologjike e sipërfaqes së tokës duke përfshirë sipërfaqet artificiale, rajonet bujqësore, pyjet, rajonet (gjysmë-)natyrore, moçalet dhe trupat ujore.</p> <p>3. Ortofoto imazhet; Të dhënat (imazhet) e gjeo referencuara të sipërfaqes së tokës, nga sensorët e satelitit apo aeroplanit.</p>	<p>October 2000 on establishing a framework for the European Union's activities in the field of water rules and in the form of networks.</p> <p>9. Protected areas; Areas defined and managed within the international legal framework of the European Union Member States and the European Union to achieve the specific goals of preserving these areas.</p> <p>Appendix 2.</p> <p>1. Height; Digital elevation models for land, glaciers and surface water. Includes height of land, measuring the depth of water and shores.</p> <p>2. Land cover; Physical and biological cover of the earth's surface including artificial surfaces, agricultural areas, forest areas (semi -) natural, wetlands and water bodies.</p> <p>3. Orthophoto images; The data (images) of geo referenced to the earth's surface from satellite sensors or plane.</p>	<p>Evropske unije u oblasti propisa o vodama i oblika mreže.</p> <p>9. Zaštićena područja; Utvrđene i upravljene površine unutar međunarodnog pravnog okvira, država članica Evropske unije i Evropske unije za postizanje konkretnih ciljeva očuvanja ovih površina.</p> <p>Dodatak 2.</p> <p>1. Visina; Digitalni modeli visin za zemljište, glečere i vodnih površina. Uključuje visinu zemljišta, merenje vode i obale.</p> <p>2. Zemljišni pokrivač; Fizički i biološki pokrivač zemljine površine, uključujući veštačke površine, poljoprivredne regione, šume, polu prirodne regjione, močvare i vodna tela.</p> <p>3. Ortofoto snimci; Georeferentni podaci (snimci) površine zemlje, od satelitskih senzora ili aviona.</p>
---	---	---

<p>4. Gjeologjia; Gjeologjia e karakterizuar sipas përmbajtjes dhe strukturës, përfshinë shtresat shkëmbore nën tokë, shtratet (akuiferet) ujëmbajtëse dhe gjeomorfologjinë.</p> <p>Shtojca 3.</p> <p>1. Njësitë statistikore; Njësitë për shpërndarjen apo shfrytëzimin e informacioneve statistikore.</p> <p>2. Ndërtesat; Lokacioni gjeografik i ndërtesave.</p> <p>3. Dheu; Dheu dhe nënshtresat të karakterizuara sipas thellësisë, strukturës dhe përmbajtjes së thërrimeve dhe materialit organik shkëmbor, erozionit, aty ku është e mundur pjerrtësinë kryesore dhe kapacitetin e paraparë të depozitimit të ujit.</p> <p>4. Shfrytëzim i tokës; Territor i karakterizuar sipas dimensionit funksional të planifikuar apo qëllimit socio-ekonomik të tanishëm apo të ardhshëm (p.sh. për banim, industrial, komercial, bujqësor, pyjor, rekreativ).</p>	<p>4. Geology; Geology characterized by content and structure, includes underground rock layers, beds (aquifers) and geomorphology.</p> <p>Appendix 3.</p> <p>1. Statistical units; Units for dissemination or use of statistical information.</p> <p>2. Buildings; Geographical location of buildings.</p> <p>3. Soil; Soil and subsoil characterized according to depth, structure and content of organic, crumbs and rocky material, erosion, where possible main slope and anticipated storage capacity of water.</p> <p>4. Land use; Territory characterized according to planned functional dimension or socio - economic purpose of the present or future (eg residential, industrial, commercial, agricultural, forestry, recreational).</p>	<p>4. Geologjia; Geologjia karakterizovana prema sadržaju i strukturi, obuhvata podzemne slojeve stena, vodoodržljiva korita (akvifere) i geomorfologiju.</p> <p>Dodatak 3.</p> <p>1. Statističke jedinice; Jedinice za raspodelu ili korišćenje statističkih informacija.</p> <p>2. Zgrade; Geografska lokacija zgrada.</p> <p>3. Zemljište; Zemljište i podslojevi karakterističnih po dubini, strukturi i sadržaju čestica i stenovitog organskog materijala, eroziji, tamo gde je moguće glavnim nagibom i predviđenim kapacitetom skladištenja vode.</p> <p>4. Korišćenje zemljišta; Teritorija okarakterisana prema planiranoj funkcionalnoj dimenziji ili sadašnjoj ili budućoj društveno-ekonomskoj svrhi (na pr. stambena, industrijska, komercijalna, poljoprivredna, šumarska, rekreativna).</p>
---	---	--

<p>5. Shëndeti dhe siguria e njerëzve; Shtirja gjeografike e dominimeve të patologjive (alergjitë, kancerit, sëmundjet e organeve të frymëmarrjes, etj.), informacionet të cilat tregojnë efektin në shëndet (biomarkerët, rënia e natalitetit, epidemitë) apo mirëqenien e njerëzimit (ankthet, streset, etj.) të lidhura drejtpërdrejtë (ndotja e ajrit, materiet kimike, zbërthimi i shtresës së ozonit, zhurma etj.) apo të tërthortë (ushqimi, organizmat e modifikuar gjenetiksht, etj.) në kualitetin e mjedisit.</p>	<p>5. Health and human security; The geographical distribution of domination of pathologies (allergies, cancers, respiratory diseases, etc.), Information which show effects on health (biomarker, the decline of fertility, epidemics) or well-being of mankind (anxiety, stress, etc.) connected directly (air pollution, chemical substances, decomposition of the ozone layer, noise, etc.) or indirectly (food, genetically modified organisms, etc.) to the quality of the environment.</p>	<p>5. Zdravlje i bezbednost ljudi; Geografsko prostiranje dominacije patologije (alergije, raka, bolesti disajnih organa itd.), informacije koje pokazuju uticaj na zdravlje (biomarkeri, pad nataliteta, epidemije) ili blagostanja čovečanstva (anksioznost, stres itd.) povezanih direktno (zagađenje vazduha, hemijske materije, razaranja ozonskog sloja, buka itd.) ili indirektno (hrana, genetski modifikovani organizmi itd.) na kvalitet životne sredine.</p>
<p>6. Shërbimet publike komunale dhe qeveritare; Përfshijnë objektet e shërbimeve komunale dhe qeveritare siç janë kanalizimi, menaxhimi i mbeturinave, furnizimi me energji dhe ujë, shërbimet qeveritare administrative dhe sociale siç është administrata publike, objektet e mbrojtjes civile, shkollat dhe spitalet.</p>	<p>6. Government and public utilities; Include facilities of governmental and municipal services such as sewerage, waste management, energy and water supply, administrative and social governmental services such as public administration, civil defense facilities, schools and hospitals.</p>	<p>6. Komunalne i javne usluge; Uključuju objekte javnih i državnih službi kao što su kanalizacija, upravljanje otpadom, snabdevanje električnom energijom i vodom, državno administrativne i socijalne službe, objekte za civilnu zaštitu, škole i bolnice.</p>
<p>7. Objektet për monitorimin e mjedisit; Lokacioni dhe operimi i objekteve për monitorimin e mjedisit përfshin vrojtimin dhe matjen e emetimit të gazrave, rrezatimit të gjendjes mjedisore dhe të parametrave tjerë të ekosistemit (bio-diversitetin, kushtet ekologjike të vegjetacionit, etj.) në emër të autoriteteve publike.</p>	<p>7. Facilities for environmental monitoring; Location and operation of environmental monitoring facilities includes observation and measurement of emissions, radiation and environmental status of other ecosystem parameters (biodiversity, ecological conditions of vegetation, etc.) On behalf of public authorities.</p>	<p>7. Objekti za nadzor životne sredine; Lokacija i funkcionisanje objekta za nadzor životne sredine uključuje i merenje emisije gasova, zračenja životne sredine i drugih parametara ekosistema (bio-diverzitet, ekološki uslovi vegetacije itd.) u ime javnih organa.</p>
<p>8. Objektet e prodhimit dhe ato industriale;</p>	<p>8. Industrial and production facilities;</p>	<p>8. Proizvodna i industrijska postrojenja;</p>

<p>Objektet prodhuese industriale, përfshire objektet sipas Udhëzimit të Këshillit Evropian 96/61/EC të datës 24 shtator 1996 lidhur me pengimin dhe kontrollimin e integruar të ndotjes si dhe objektet e ujit, minierat, deponitë.</p>	<p>Industrial manufacturing facilities, including facilities according to European Council Directive 96/61/EC of 24 September 1996 concerning integrated prevention and pollution control and water facilities, mines, landfills.</p>	<p>Industrijska proizvodna postrojenja, uključujući i postrojenja u skladu sa Uputstvima Evropskog saveta 96/61/EC od 24 septembra 1996 u vezi sa sprečavanjem i integrisanom kontrolom zagađenja kao i postrojenja vode, rudnici, deponije.</p>
<p>9. Objektet bujqësore dhe të ujitjes; Pajisjet bujqësore dhe objektet e prodhimit (përfshirë sistemet e ujitjes, serat dhe stallat).</p>	<p>9. Agricultural and irrigation facilities; Agricultural equipment and production facilities (including irrigation systems, greenhouses and stables).</p>	<p>9. Objekti za poljoprivredu i navodnjavanje; Poljoprivrena oprema i proizvodni objekti (uključujući sisteme za navodnjavanje, sere, štale).</p>
<p>10. Shtrirja e popullatës - demografia; Shtrirja gjeografike e popullsisë përfshire karakteristikat e dëndesisë së popullsisë dhe nivelet e aktiviteteve të paraqitura sipas rrjetit, regjionit, njësisë administrative apo ndonjë njësie tjetër analitike.</p>	<p>10. The distribution of the population - demographics; The geographical distribution of population including population density characteristics and levels of activities indicated by the network, region, administrative unit or any other analytical unit.</p>	<p>10. Rasprostranjenost stanovništva - demografija; Rasprostranjenost stanovništva uključujući karakteristike gustine stanovništva i nivoa aktivnosti predstavljenih prema mreži, regionu, administrativnoj jedinici ili bilo kojoj drugoj analitičkoj jedinici.</p>
<p>11. Zonat e sipërfaqeve të administruara /ndalesave/rregullimit dhe njësitë e raportimit; Sipërfaqet e administruara, rregulluara apo të shfrytëzuara për raportim në nivelet ndërkombëtare, evropiane, shtetërore dhe lokale. Përfshinë deponitë e mbeturinave, vendet (sipërfaqet) me ndalesa përreth burimeve të ujit që pihet, zonat që janë në rrezik nga nitratat, vijat e rregulluara të udhëtimit në ujërat tjera brenda vendit, sipërfaqet për hedhjen e mbeturinave, zonat ku ndalohet</p>	<p>11. Administered areas / restrictions / regulation and reporting units; Areas managed, regulated or used for reporting at the international, European, national and local level. Includes landfills, sites (areas) with stops around drinking water sources, areas that are at risk from nitrate, travel lines arranged in other domestic waters, waste disposal areas, prohibited noise areas, areas intended for development and allowed for the extraction of minerals, areas of river beds, relevant</p>	<p>11. Područja upravljanja /zabrana/uređenja područja i jedinica za izveštavanje; Oblasti upravljanja, regulisanih ili korišćenih za izveštavanje na međunarodnom, evropskom, državnom i lokalnom nivou. Uključuje deponije otpada, mesta (površine) sa zabranama oko izvora pijaće vode, područja koji su u opasnosti od nitrata, regulisanih putnih linija u drugim domaćim vodama, površine za bacanje otpada, područja gde je zabranjena buka, površine predviđene za razvoj i površine dozvoljene za</p>

<p>zhurma, sipërfaqet e parapara për zhvillim dhe sipërfaqet e lejuara për nxjerrjen e xeheve, zonat e shtretërve të lumenjve, njësitë relevante për raportim dhe zonat e administruara ujore.</p> <p>12. Zonat e rrezikut natyror; Zonat e karakterizuara sipas rreziqeve natyrore (të gjitha fenomenet atmosferike, hidrologjike, seizmike, vullkanike, zjarreve, të cilat për shkak të lokacionit të tyre, shkallës dhe frekuences së rrezikut, të cilat mund ta dëmtojnë seriozisht shoqërinë), p.sh. vërshimet, rrëshqitjet e dheut, orteqet, zjarret e pyjeve, tërmetet, erupsionet vullkanike.</p> <p>13. Kushtet atmosferike; Kushtet fizike në atmosferë, përfshirë të dhënat hapësinore të bazuara në matjet, në modelet apo në kombinimin e tyre ku janë kryer matjet.</p> <p>14. Treguesit meteorologjik gjeografik; Kushtet e motit dhe matjet e tyre, të reshurat, temperatura, avullimi, shpejtësia dhe drejtimi i erës.</p> <p>15. Treguesit oqeanografik gjeografik; Kushtet fizike të oqeaneve (rrymat, kripshmëria, lartësia e valëve, etj.). (Kjo pikë nuk zbatohet për territorin e RK.)</p>	<p>reporting units and aquatic managed areas.</p> <p>12. Natural risk zones; Areas characterized according to natural hazards (all atmospheric, hydrological, seismic, volcanic, fires phenomena, which due to their location, scale and frequency of risk, which can seriously harm society), eg floods, landslides, avalanches, forest fires, earthquakes, volcanic eruptions.</p> <p>13. Weather conditions; Physical conditions in the atmosphere, including spatial data based on measurements, on models or on a combination of their own where measurements were performed.</p> <p>14. Meteorological geographical indicators; Weather conditions and their measurements, rainfall, temperature, evaporation, wind speed and direction.</p> <p>15. Oceanographic geographical indicators; Physical conditions of oceans (currents, salinity, wave height, etc.). (This paragraph does not apply to the territory of RK.</p>	<p>vađenje rude, područja rečnih korita, relevantnih jedinica za izveštavanje i kontrolisana vodna područja.</p> <p>12. Područja prirodnih opasnosti; Područja karakterističnih prema prirodnim opasnostima (sve atmosferike, hidrološke, seizmičke, vulkanske pojave, požari, koji zbog njihovih lokacija, stepena i učestalosti opasnosti, mogu ozbiljno da ugroze društvo), na pr. poplave, klizanje zemljišta, lavine, šumski požari, zemljotresi, vulkanske erupcije.</p> <p>13. Atmosferski uslovi; Fizički uslovi u atmosferi, uključujući prostorne podatke baziranih na merenjima, modele ili njihovoj kombinaciji gde su vršena merenja.</p> <p>14. Meteorološko-geografski pokazivači; Vremenski uslovi i njihove dimenzije, padavine, temperature, isparavanje, brzina i pravac vetra.</p> <p>15. Okeanografsko-geografski pokazivači; Fizički uslovi okeana (struje, slanost, visina talasa, itd.). (Ova tačka ne primenjuje se za teritoriju Kosova).</p>
--	---	--

<p>16. Regjionet detare; Kushtet fizike të deteve dhe ujërat me kripë të ndara në regjione dhe nën-regjione me karakteristika të përbashkëta. (Kjo pikë nuk zbatohet për territorin e RK.</p> <p>17. Regjionet bio-gjeografike; Regjionet me kushte ekologjike relativisht homogjene dhe me karakteristika të përbashkëta.</p> <p>18. Vendbanimet e gjallesave dhe bio-llojet; Rajonet gjeografike që i karakterizojnë kushtet specifike, proceset, strukturën dhe funksionet ekologjike të cilat fizikisht i mbështesin gjallesat që jetojnë aty, përfshirë rajonet tokësore dhe ujore të cilat dallohen me karakteristika gjeografike, jo biotike dhe biotike, qofshin tërësisht natyrore apo gjysmë natyrore.</p> <p>19. Shpërndarja e llojeve të gjallesave; Shtrirja gjeografike e llojeve të shtazëve apo bimëve sipas rrjetit, regjionit, njësisë administrative apo ndonjë njësie tjetër analitike.</p> <p>20. Burimet energjetike; Burimet energjetike përfshirë hidrokarburet, hidro-energjinë, bio-energjinë, solare, erërat, etj, sipas rëndësisë përfshihen edhe informacionet e thellësisë/lartësisë mbi shkallën</p>	<p>16. Marine regions; Physical conditions of seas and salt water separated into regions and sub- regions with common characteristics. (This paragraph does not apply to the territory of RK.</p> <p>17. Bio-geographical regions; Regions with relatively homogeneous ecological conditions and with common characteristics.</p> <p>18. Habitats of living organisms and bio - types; Geographical regions that characterize specific conditions, processes, structure and ecological functions that physically support the living organisms there, including land and water areas which are distinguished by geographical features, not biotic and biotic, whether entirely natural or semi-natural.</p> <p>19. The distribution of animal species; The geographical distribution of species of animals or plants by grid, region, administrative unit or any other analytical unit.</p> <p>20. Energy resources; Energy resources including hydrocarbons, hydro - energy, bio - energy, solar, wind, etc. according to importance including information of depth / altitude above the</p>	<p>16. Morske regije; Fizički uslovi mora i slanih voda odvojenih na regjione i pod regjione sa zajedničkim karakteristikama. (Ova tačka ne primenjuje se za teritoriju Kosova).</p> <p>17. Bio-geografske regije; Regioni sa relativno homogenim ekološkim uslovima i zajedničkim karakteristikama.</p> <p>18. Staništa i raznovrsnost bioloških vrsta; Geografski regioni koje karakterišu specifični uslovi, procesi, strukture i ekološke funkcije koji fizički podržavaju živa bića koji tamo žive, uključujući kopnene i vodene regione koji se odlikuju geografskim karakteristikama, biotičkim i abiotičkim, bilo da su u celini prirodni ili poluprirodni.</p> <p>19. Rasprostranjenost vrsta; Geografsko prostiranje biljnih ili životinjskih vrsta prema mreži, regionu, administrativnoj ili nekoj drugoj analitičkoj jedinici.</p> <p>20. Izvori energije; Energetski izvori uključujući hidrokarburante, hidro- energiju, bio-energiju, solarnu energiju, energiju vetra itd. prema značaju uključuje i informacije o dubini/visini iznad nivoa izvora.</p>
--	--	--

e burimit.	level of the source.	
<p>21. Burimet e mineraleve;</p> <p>Burimet e mineraleve përfshire xehet e metaleve, mineralet industriale etj, sipas rëndësisë përfshihen edhe informacionet e thellësisë/lartësisë mbi shkallën e burimit.</p>	<p>21. Mineral resources;</p> <p>Mineral resources including metal ores, industrial minerals, etc. according to the importance including information of depth / altitude above the level of the source.</p>	<p>21. Izvori minerala;</p> <p>Izvori minerala uključujući rude metala, industrijskih minerala itd. prema značaju uključuje i informacije o dubini/visini iznad nivoa izvora.</p>